



VENDIMI MBI PRANUESHMËRINË DHE MERITAT E LËNDËS

Data e miratimit: 26 mars 2021

Nr. i lëndës: 2016-21

Milanka Čitlučanin

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 26 mars 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike në pajtim me Rregullën 13(3) të Rregullores së punës së Panelit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 30 qershor 2016.
2. Me një letër të datës 1 korrik 2016, Paneli informoi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") se kjo lëndë ishte regjistruar.
3. Më 3 tetor 2016, ankuesja paraqiti një numër dokumentesh shtesë.
4. Më 20 shtator 2017, Paneli dërgoi një kërkesë për informacion shtesë përmes përfaqësuesit për familjet serbe të Qendrës Burimore të Personave të Zhdukur (QBPZH), një organizatë joqeveritare me seli në Prishtinë. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk u mor në lidhje me këtë rast në atë fazë.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i transmetoi një Deklaratë të Fakteve dhe Pyetjeve shefit të Misionit (ShM), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar Misionin të paraqesë përgjigje dhe vërejtje me shkrim mbi ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018.
6. Me një letër të datës 19 janar 2019, Misionit iu kërkua përsëri të jepte përgjigje për pyetjet, këtë herë jo më vonë se me datën 16 shkurt 2019.

7. Me anë të një letre të datës 31 janar 2019, ankueses iu kërkua të paraqesë një kopje të nënshkruar të formularit të aplikimit. Forma e aplikimit e nënshkruar është dorëzuar në 11 shkurt 2019.
8. Me një letër të datës 8 prill 2019, Misionit iu kërkua përsëri të jepte përgjigje për pyetjet sa më shpejt që të ishte e mundur.
9. Më 20 qershor 2019, ankuesja u informua se Paneli ishte ende në proces të shqyrtimit të ankesës së saj.
10. Më 26 shkurt 2020, më shumë se dy vjet pasi u pyet për herë të parë, ShM-ja paraqiti vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë e ankesës.
11. Më 4 mars 2020, letra e ShM-së u dërgua për informacion ankueses, të cilës iu ishte dhënë afat deri më 4 prill 2020 për të bërë ndonjë parashtim të mëtejshëm në përgjigje të asaj letre. Ankuesja nuk dha ndonjë përgjigje.
12. Me një letër të datës 8 shtator 2020, Paneli informoi Misionin se, për të shpejtuar procedurat, Paneli kishte për qëllim të merrej me çështjet e pranueshmërisë dhe meritës në të njëjtën kohë në një vendim të vetëm. Për këtë qëllim, Paneli ftoi Misionin të paraqesë parashtresat e tij për meritë në ato raste kur ai kishte dhënë tashmë komentet e tij mbi pranueshmërinë.
13. Më 11 dhjetor 2020, Misioni paraqiti komente shtesë në lidhje me meritën e ankesës.
14. Më 17 dhjetor 2020, komentet e Misionit për meritat iu përcollën ankueses, e cila u ftua të paraqesë komentet e saj mbi meritat e lëndës, nëse ka pasur ndonjë, para datës 31 janar 2021.
15. Për shkak të një ndërlíkimi të paparashikuar me dërgimin e komunikimeve postare, më 1 shkurt 2021, Paneli vendosi të zgjasë afatin për ankuesen që të paraqesë komente mbi meritat e lëndës deri më 26 shkurt 2021. Afati u zgjat më tej deri në 19 mars 2021. Asnjë parashtim tjetër nuk u mor.

II. FAKTET

16. Faktet e lëndës, siç duket nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë. Më 21 tetor 1999, vëllai i ankueses, Milorad Daničić, së bashku me një numër kolegësh, kishte udhëtuar me autobus nga shtëpia e tij në Leposavić, në zyrën e Kompleksit Industrial Trepça në anën jugore të Mitrovicës në mënyrë që të merrte pagën e tij.
17. Me sa duket, Milorad Daničić kishte shkuar në zyrën e tij për të mbledhur diçka ndërsa kolegët e tij po hynin në autobus në mënyrë që të transportoheshin në shtëpi. Thuhet se, një grup i shqiptarëve të Kosovës iu afruan autobusit në një mënyrë kërcënuese dhe autobusi u nis, duke lënë Milorad Daničićin dhe disa kolegë të tjerë prapa. Një grup kolegësh arritën të ktheheshin në shtëpi, por Milorad Daničić nuk u dëgjua dhe nuk u pa më.
18. Ankuesja raportoi zhdukjen e vëllait të saj te Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) në Beograd, ku u hap një kërkesë për gjurmim.
19. Më 23 nëntor 1999, Njësia Rajonale e Hetimeve në Mitrovicë e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) hapi një çështje penale,

dhe më 25 nëntor 1999, Njësia e Personave të Zhdukur e UNMIK - NJPZ hapi një dosje të personave të zhdukur.

20. Më 24 prill 2000, ankuesja bëri një deklaratë prej dëshmitari tek gjykatësi hetues i "Gjykatës Komunale të Kosovska Mitrovicës" të Republikës së Serbisë, në procedurat penale kundër një pale të tretë. Në deklaratën e saj, ankuesja pretendon se ajo kishte informacione se vëllai i saj ishte mbajtur në një burg të paligjshëm në fshatin Likovc. Ajo kishte informuar Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë për këtë. Me sa duket, OSBE hetoi këtë pretendim, por nuk gjeti asnjë gjurmë të Milorad Daničićit në atë vend.
21. Raportohet se Njësia e UNMIK-ut për Krimet e Luftës – NjKL, gjithashtu kishte informacione se Milorad Daničić ishte ndaluar për disa ditë pas zhdukjes së tij, por nuk ishte në gjendje ta konfirmonte këtë informacion.
22. Arkivat e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IFM), që veprojnë nën Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës, me mbështetjen e Misionit, përmbajnë një Formular për Identifikimin e Viktimave për Milorad Daničić.

III. ANKESA DHE QËNDRIMI

23. Ankuesja pretendon se kurrë nuk ka pasur ndonjë hetim në lidhje me zhdukjen e vëllait të saj i cili u zhduk në tetor 1999 dhe nuk u dëgjua më kurrë për të. Ajo nuk specifikon ndonjë të drejtë (të drejta) të caktuara që thuhet se është prekur nga ky dështim i pretenduar.
24. Paneli konsideron që ankesa ka të bëjë me të paktën dy të drejta themelore të veçanta të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), e cila garanton të drejtën themelore të një personi për jetën dhe, nën udhëheqjen e tij procedurale, parashikon një detyrim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; dhe, neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e një personi për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit ose trajtimi çnjerëzor ose poshtërues
25. Për më tepër, ankesa mund të jetë e relevante për të drejtën e parashikuar me nenet 8 dhe 13 të së njëjtës Konventë, e cila garanton, përkatësisht, të drejtat në jetën familjare dhe qasjen në një zgjidhje efektive për këdo, të drejtat dhe liritë e të cilit që parashikohen në Konventë dyshohet se janë shkelur.
26. Të njëjtat të drejta mbrohen nga një numër traktatesh të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut që u garantohen të gjithëve si çështje e së drejtës ndërkombëtare.
27. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare midis viktimës kryesore - të Milorad Daničić - dhe ankueses - Milanka Čitlučanin (motra e Milorad Daničić) - Paneli është i bindur që ankuesja mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe që, si e tillë, një viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

IV. PARASHTRESAT E PALËVE NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Ankuesja

28. Siç u përmbledh më lart, ankuesja pretendon që, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë do të duhej të kishte hetuar zhdukjen dhe vrasjen e vëllait të saj dhe për fat të keq nuk kishte arritur ta bënte këtë duke shkelur të drejtat themelore të saj dhe të vëllait të saj.

Shefi i Misionit (“ShM”)

29. Në parashtrirat e tij të 26 shkurtit 2020, shefi i Misionit paraqiti sa vijon. Lidhur me informatën e Misionit për këtë rast, shefi i Misionit tregoi se brenda kornizës së transferimit të lëndëve dhe dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u në Mision, ky i fundit ishte njoftuar për ekzistencën e kësaj lënde. Shefi i Misionit tha se Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës të EULEX-it (NJHKL) mori ‘vetëm disa dokumente në lidhje me zhdukjen e Milorad Danicicit’. Kjo përfshinte një Raport të Hetimeve Ante-Mortem të Njesisë së UNMIK-ut për Krime Luftë - Seksioni për Personat e Zhdukur dhe një përkthim në anglisht i procesverbalit të një seance dëgjimore të datës datës 24 prill 2000 para një gjykatësi hetues në Gjykatën Komunale në Kosovska Mitrovica ku ankuesja u paraqit si dëshmitare. Misioni shton se EULEX-i ‘nuk ka njohuri se ku mund të jenë procesverbalet origjinale’.
30. Raporti i Hetimit *Ante Mortem* i UNMIK-ut deklaroi se zhdukja e z. Daničić ishte raportuar në KNKK në Beograd; se Njësia Rajonale Hetimore e UNMIK-ut në Mitrovicë kishte hapur një dosje të personit të zhdukur dy ditë më vonë, më 25 nëntor 1999; që një staf i UNMIK-ut kishte kontaktuar ankuesen në një moment edhe pse ajo nuk ishte në gjendje të siguronte informata shtesë; dhe se përmbante emrin e pronarit të vendit ku z. Daničić dyshohej të ishte ndaluar, megjithëse ai nuk mund të gjurmohet nga UNMIK-u. Raporti konkludoi që lënda duhet të mbetet ‘aktive e hapur’.
31. Arkivat e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IFM) përmbajnë një kopje të një dokumenti të OSBE-së që mban shënimin ‘konfidencial’.
32. Në kohën e dorëzimit të lëndëve dhe shkresave të lëndëve nga UNMIK-u tek Misioni, lënda e Milorad Daničić-it u përfshi në bazën e të dhënave të Njesisë së UNMIK-ut për Personat e Zhdukur.
33. Misioni e bëri të qartë se dokumentet në lidhje me këtë rast ishin transmetuar nga UNMIK-u gjatë periudhës prill - dhjetor 2008 së bashku me një numër të madh të dosjeve të ngjashme. Misioni gjithashtu ofroi një shpjegim të gjatë të procesit të regjistrimit, ruajtjes dhe kategorizimit të dosjeve të lëndëve të marra nga UNMIK-u. Misioni nuk e bën të qartë se si ndikoi ky proces në trajtimin e lëndës këtu. Sidoqoftë, ai tregon për një numër mangësish që ndikojnë në mënyrën në të cilën UNMIK-u kishte organizuar dhe regjistruar rastet e tij. Si rezultat, Misionit iu desh të bënte disa rishikime të të dhënave të tij. Ai gjithashtu thekson që raste të caktuara i kaluan Prokurorisë së Qarkut dhe se NJHKL-ja i dha përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturave ‘dosjeve të krimeve të luftës’ ndaj ‘dosjeve të personave të zhdukur’.
34. I pyetur se çfarë hapash ndërmori Misioni për të hetuar rastet e zhdukjes me forcë që datojnë që nga konflikti i Kosovës (ose pasojat e tij menjëherë), Misioni ofron një përshkrim të hollësishëm të hapave të caktuar që ndërmori në atë drejtim. Misioni shkurtimisht përgjigjet se ‘jo drejtpërdrejtë, [ai] hetoi dhe ndoqi penalisht raste të zhdukjeve me forcë brenda kuadrit të rasteve të krimeve të luftës’.
35. Lidhur me rastin në fjalë, Misioni tha se

'Duket se EULEX-i nuk e hetoi këtë zhdukje për shkak të mungesës së pistave të dukshme hetimore dhe nevojës për t'u dhënë përparësi lëndëve për të cilat provat ishin më të rëndësishme'.

36. Misioni nuk iu përgjigj pyetjes së Panelit në lidhje me përpjekjet për të kontaktuar institucione të tjera (p.sh. OSBE-në; UNMIK-un; ICRC; autoritetet serbe) për të marrë informacion në lidhje me atë rast.
37. I pyetur nëse di ndonjë autoritet tjetër që heton këtë rast, Misioni e ftoi ankuesen që t'ia drejtojë këtë pyetje institucioneve kompetente të Kosovës. Paneli thekson këtu që pyetja nuk ishte e ankueses, por e Panelit. Paneli thekson më tej se dështimi i Misionit për t'u përgjigjur duhet të nënkuptojë se Misioni nuk ka njohuri të tilla.
38. I pyetur nëse familjarët e të zhdukurve ishin informuar dhe përfshirë në ndonjë moment, Misioni përgjigjet se ankuesja iu dha informacion organizatave të ndryshme, por jo EULEX-it. Kjo paraqitje nuk i përgjigjet pyetjes së Panelit. Paneli konkludon nga kjo se Misioni nuk kërkoi të kontaktojë ndonjë nga të afërmit e personit të zhdukur. As të dhënat nuk sugjerojnë që ai t'i siguronte ndonjërit prej tyre informacione që kishte në posedim në lidhje me fatin e z. Dancic.
39. Misioni gjithashtu pranoi se asnjë dëshmitar ose i dyshuar i mundshëm nuk u mor në pyetje nga Misioni në lidhje me këtë rast.
40. Lidhur me pyetjen e Panelit nëse Misioni kishte shkelur të drejtat e ankueses sipas neneve 2 ose 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Misioni u përgjigj se në këndvështrimin e tij nuk ka ndodhur asnjë shkelje e tillë. Në veçanti, Misioni paraqiti:

'EULEX-i nuk konteston që ankuesja ka të drejtë të dijë se çfarë i ka ndodhur vëllait të saj dhe se lënda ngre çështje sipas Konventës. Sidoqoftë, gjykon se një vlerësim i sjelljes së EULEX-it nën kreun procedural të nenit 2 dhe nën nenit 3 të konventës në lidhje me këtë zhdukje specifike, nuk mund të shpërfillë madhësinë e sfidës të paraqitur nga numri shumë i lartë i krimeve gjithashtu si kontekst dhe rrethanat në të cilat Misioni u thirr për të zbatuar mandatin e tij.

Mbi atë bazë, Misioni fton Panelin të vlerësojë veprimet e Misionit në një mënyrë reale dhe proporcionale.

41. Misioni shtoi se '[natyra] e rrethanave të përgjithshme në të cilat EULEX-u u thirr për të zbatuar mandatin e tij kërkonte përparësinë e disa lëndëve ndaj të tjerave'. Ai shtoi:

'I kufizuar nga burimet e kufizuara në dispozicion të tij, si dhe afati i shkurtër i mandatit të tij (që nga fillimi i tij në 2008, mandati i EULEX-it është zgjatur çdo dy vjet), Misioni u detyrua të merrte vendime të vështira me shpejtësi për të shmangur ndonjë bllokim të plotë. Misioni besoi se kualifikimi fillestar i veprave të pretenduara penale nga UNMIK-u duhet të ketë qenë në rregull dhe vendosi që t'i jepte përparësi shqyrtimit dhe ekzaminimit të rreth 1,200 dosjeve të lëndëve që ishin etiketuar tashmë nga UNMIK-u si "krime lufte" mbi të ashtuquajturat "dosjet e personave të zhdukur". Brenda kategorisë 'krime lufte', ai i identifikoi ato lëndë që dukeshin më premtuese sa i përket rezultateve hetimore dhe pushoi të tjerat. EULEX-i nuk ndërmori ndonjë përpjekje sistematike për të gjetur të gjitha dosjet e mundshme, ndonjë pjesë të dosjeve, ose dokumente që mund të jenë mbajtur nga organizata të tjera, dhe u përqendrua në materialin që kishte marrë nga UNMIK-u. Siç u shpjegua më lart, prokurorët e EULEX-it konsideruan se ata duhet të përqendroheshin në veprat e pretenduara penale që ishin kryer gjatë

konfliktit të armatosur dhe t'ia linin rastet pas konfliktit zyrove themelore të prokurorisë'.

42. Misioni më tej paraqiti:

'Misioni pranon që njësitë e tij policore dhe prokuroriale mund të kishin bërë më shumë për të mbajtur viktimat dhe publikun e gjerë të informuar për strategjitë dhe kufizimet e tij me qëllim që të menaxhonte pritjet në mënyrë më adekuate dhe të ishte më transparente. Sidoqoftë, ai pohon se do të kishte qenë thjesht joproporcionale të pritej që Misioni të mund të hetojë të gjitha vrasjet dhe zhdukjet në të njëjtën kohë, si dhe të mbajë të gjithë të afërmit e viktimave të informuar për statusin e çdo hetimi. Prandaj, në rastin aktual dhe duke marrë parasysh pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankueses ishin shkelur'.

43. Më në fund, Misioni tha këtë:

'EULEX-i dëshiron të theksojë, ashtu si bëri në lidhje me rastet e tjera të ngjashme që janë në pritje të Panelit që nën mandatin e tij të rikonfiguruar Misioni mban një kapacitet ekzekutiv për të mbështetur IFM të Kosovës. Nëse informata të reja të besueshme dalin në dritë, Misioni është i gatshëm të mbështesë institucionet e Kosovës në çdo përpjekje për të gjetur z. Milorad Daničićin dhe personat e tjerë të zhdukur'.

V. VLERSIMI I PANELIT LIDHUR ME PRANUESHMËRINË E LËNDËS

44. Në fakt, Misioni nuk e sfidon pranueshmërinë e kësaj lënde dhe merr parasysh faktin që Paneli në të kaluarën ka deklaruar të pranueshme lëndë të një natyre të ngjashme.
45. Paneli me të vërtetë është i bindur që të gjitha kushtet e pranueshmërisë janë përmbushur në lidhje me këtë rast.

VI. VLERSIMI I PALËVE LIDHUR ME MERITAT E LËNDËS

Ankuesja

46. Siç u përmend më lart, ankuesja pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë do të duhej të kishte hetuar zhdukjen dhe vrasjen e vëllait të saj dhe me faj nuk kishte arritur ta bënte këtë duke shkelur të drejtat themelore të saj dhe të vëllait të saj. Paneli ka vendosur më lart që ankuesja këtu duhet të merret në konsideratë në bazë të neneve 2 (pjesë procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shefi i Misionit ("ShM")

47. Me një letër të 11 dhjetorit 2020, shefi i Misionit tregoi se nuk kishte 'nevojë' për parashtrime shtesë në lidhje me meritat e kësaj lënde dhe pohon se 'Misioni nuk beson se të drejtat e ankueses ishin shkelur'.
48. Sidoqoftë, Misioni bëri një numër parashtrimesh të përgjithshme në lidhje me disa nga sfidat praktike që lidhen me hetimin e këtij lloji të lëndëve dhe pranoi që menaxhimi i dosjes së UNMIK-ut kishte shkaktuar probleme.

Parashtrimet si përgjigje

49. Më 17 dhjetor 2020, parashtrirat e Misionit për meritat e lëndës iu përcollën ankueses, e cila u ftua të paraqesë komentet e saj mbi meritat e lëndës, nëse ka pasur, para datës 31 janar 2021.
50. Për shkak të një ndërlikimi të paparashikuar me dërgimin e komunikimeve postare, më 1 shkurt 2021, Paneli vendosi të zgjasë afatin për ankuesen që të paraqesë komente mbi meritat e lëndës deri më datën 26 shkurt 2021. Asnjë parashtrim tjetër nuk u mor.

VII. VLERSIMI I PANELIT LIDHUR ME MERITAT E LËNDËS

Konsiderata të përgjithshme

51. Misionit iu kërkua të përmbushë përgjegjësitë e tij ekzekutive në një mënyrë që përputhet me standardet përkatëse të drejtave të njeriut. *Ndër të tjera* kjo nënkuptonte se do të hetonte lëndët brenda kompetencës së tij juridikionale që përfshinin shkeljen e të drejtave të garantuara sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Lidhur me standardet përkatëse ligjore të zbatueshme, shih: PShDNj, Shënim i Praktikës Gjyqësore mbi Detyrimin për Hetimin e Pretendimeve të Shkeljeve të Drejtave, fq. 3-5 (dhe ligj i lëndëve të cituara); dhe *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 36; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 88; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 29 shtator 2015, par. 58. Shih gjithashtu GjEDNj: Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Aplikacioni nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i 6 korrikut 2005, par. 110; *Hugh Jordan kundër Mbretëria e Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i 4 majit 2001, par. 105; *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 27 Shtator 1995, Seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët k. Bullgarisë*, Aktgjykimi i 28 tetorit 1998, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-VIII, par. 102.
52. Gjithashtu Misionit i kërkohet t'i u jepte një vlerësim të afërmve të zhdukurve në mënyrë të duhur rreth përpjekjeve të veta për të hetuar këtë rast. PShDNj-ja, Shënim i lëndëve gjyqësore mbi detyrën për të hetuar pretendimet e shkeljeve të drejtave, fq. 28-30 (dhe praktikën gjyqësore të cituar); dhe *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 61-63; *U.F. Kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 97; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-17, 4 qershor 2019, par. 55; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, çështja nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, paragrafët. 311-314; *Isayeva k. Rusisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 paragrafët. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167).
53. Lënda këtu, si dhe lëndët e tjera të zhdukjes me forcë/personave të zhdukur, kanë hyrë brenda fushës së atyre kompetencave dhe përgjegjësi.
54. Misioni çon përpara një numër argumentesh në përpjekje për të shpjeguar dështimin e tij për të hetuar lëndën këtu (dhe raste të tjera të ngjashme) dhe për t'i mbajtur të informuar siç duhet të afërmit e të zhdukurve në këtë rast.

55. Paneli thekson që shumë prej argumenteve apo shumica e tyre tashmë janë ngritur dhe janë refuzuar në raste të mëparshme të të njëjtit lloj. Prandaj, Paneli do të kufizojë konsideratat e tij në atë që është rreptësisht e nevojshme për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Sfidat që lidhen me hetimin e personave të zhdukur/rastet e zhdukjeve me forcë

56. Shefi i Misionit sygjeron që sjellja e Misionit në lidhje me rastet individuale duhet të konsiderohet në bazën e sfidës së përgjithshme që paraqet hetimi i të gjitha rasteve të personave të zhdukur për Misionin. Kjo është e saktë, por vetëm deri në një pikë.
57. Është e saktë, siç Paneli e ka pranuar në mënyrë të përsëritur, se detyra me të cilën u përball Misioni ishte shqetësuese, veçanërisht në pasojat e menjëhershme të konfliktit. Në fillim të mandatit të tij, kishte qindra raste që përfshinin shkelje serioze të të drejtave të njeriut për Misionin për të hetuar. Gjithashtu është e saktë që burimet e tij - në ekspertizë, financa dhe personel - ishin të kufizuara.
58. Për më tepër, këto hetime të vështira do të kryheshin vetëm me mbështetje të kufizuar nga autoritetet vendore dhe në një situatë pas konfliktit që do ta kishte bërë një situatë të vështirë edhe më sfiduese. Për më tepër, regjistrat e trashëguara të Misionit nga UNMIK-u ishin mbajtur dhe organizuar dobët. Kjo kërkoi që Misioni të kryejë rishikimin e tij, të përsëritur, të atyre shënimeve. Lidhur me këto vështirësi, shih gjithashtu: *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 60; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 43-45; *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012- 09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K to T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafët. 72-74; shih gjithashtu Vendimin e *Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK (PShDNj)* në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe paragrafët 70-71.
59. Parashpresa e shefit të Misionit kufizohet në faktin se mangësitë dhe dështimet e identifikuara nga Paneli në rastin aktual (dhe raste të tjera të të njëjtit lloj që kanë ardhur para Panelit) nuk janë specifike për këtë rast. Në vend të kësaj, ato pasqyrojnë mangësi sistematike dhe bazike të Misionit, duke përfshirë këto: mungesa e përgjithshme e planifikimit adekuat për hetimet dhe ndjekjet penale; mungesa e politikës së prioritizimit të rasteve; mungesa e përqendrimit në rastet që përfshijnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut; mungesa e hetimeve të shpejta dhe efektive; një dështim i përgjithshëm për të informuar të afërmit e personave të zhdukur për natyrën dhe fushën e përpjekjeve të Misionit për të gjetur të afërmit e tyre (ose eshtrat e tyre) dhe rrethanat në të cilat ata u zhdukën; asnjë politikë të qartë për rastet e zhdukjeve me forcë dhe asnjë prioritizim të tyre; numër i pakët i lëndëve të personave të zhdukur të 'zgjidhura'; Mbështetja e paarsyeshme në të dhënat dhe përcaktimin e UNMIK-ut (shih, p.sh. *QJ kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 45-47; *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Vendimi i Pranueshmërisë dhe Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 80-84); Praktikrat e diskutueshme nga personeli i prokurorisë (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 prill 2013, paragrafët 34-35; *F. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, 2011-27, Vendimi dhe Gjetjet, 5 dhjetor 2017, paragrafët 60-63); veprimet e kryera pa bazë të qartë ligjore (Shih p.sh. *W. kundër EULEX-it*, 2011-07, Vendimi dhe Gjetjet, 10 prill 2013, paragrafët 41-43; *GT kundër EULEX-it*, 2019-01, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafi 70); dështimi për të kërkuar shënime përkatëse nga burimet e mundshme të informacionit (p.sh., ICRC; autoritetet serbe; OSBE). Këta faktorë, dhe të tjerët, janë të gjithë të dukshëm nga rastet që kanë dalë para PShDNj-së. Këto nuk janë pasoja të sfidave që lidhen me mandatin

e Misionit ose me një mungesë të burimeve. Ato janë pasojë e planifikimit të dobët, menaxhim joadekuat operacional të hetimeve dhe ndjekjeve penale, mungesë e politikës së qartë të prioritizimit të lëndëve, mosvendosja e një sistemi të komunikimit me familjarët e personave të zhdukur dhe dështimi për të pasur një politikë të qartë hetimore dhe prokuroriale në lidhje me këtë lloj të rasteve. Ato gjithashtu demonstrojnë një paaftësi nga Misioni për të siguruar që planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të tij vazhdimisht të marrë parasysh detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut.

60. Gjetjet që janë bërë më lart shpresojmë se do t'i mundësojnë shefit të Misionit të vlerësojë nevojën për marrjen e masave adekuate për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të identifikuar nga Paneli në këtë lloj çështjesh dhe t'i konsiderojë këto në kontekstin e përgjithshëm të sjelljes së Misionit ndër vite.

Etiketimi ligjor dhe të drejtat e njeriut

61. Në parashtrimet e tij (shih, sipër, paragrafët 33 dhe 35), shefi i Misionit sugjeroi që NjHKL t'i jepte përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturve 'dosje të krimeve të luftës' ndaj 'dosjeve të personave të zhdukur'. Paneli thekson që dallimi i propozuar nuk mund të konsiderohet i rëndësishëm këtu. Së pari, dallimi është ligjërisht artificial: raste të zhdukjes me forcë ose personave të zhdukur mund të përbëjnë një krim lufte dhe janë ndjekur penalisht në kategori të ndryshme të krimeve të luftës që prej të paktën Luftës së Dytë Botërore. Shih p.sh., *Vesko Kandić kundër EULEX-it*, 2016-24, Vendimi i Pranueshmërisë dhe Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët. 86-92. Paneli vëren në atë aspekt se ishte njësia e krieve të luftës 'e Misionit që merrej me raste të tilla, duke e bërë të qartë se, edhe nga pikëpamja institucionale, nuk kishte asnjë konflikt midis personave të zhdukur dhe rasteve të krimeve të luftës.
62. Së dyti, nga këndvështrimi i ligjit për të drejtat e njeriut, dallimi është i pakuptimtë. Detyrimi për të hetuar që lind në një rast të tillë nga nenet 2 (pjesë procedurale) dhe 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është indiferent ndaj karakterizimit ligjor të dhënë për aktin sipas ligjeve vendore (ose ligjit ndërkombëtar). Me fjalë të tjera, nga këndvështrimi i detyrimeve të tij për të drejtat e njeriut, Misioni nuk ishte më pak i detyruar të hetojë një rast të tillë nëse e konsideronte atë si një rast krimesh lufte 'apo si rast të personit të zhdukur'. Shih, p.sh., Konventën Ndër-Amerikane për Zhdukjen e Detyruar të Personave (1994); Asambleja e Përgjithshme e KB-së, *Deklarata për Mbrojtjen e Të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë*, UN Doc A/RRES/47/133, 18 dhjetor 1992 (këtu e tutje Deklarata e 1992 për Zhdukjen me Forcë), art. 1 (1); Këshilli Ekonomik dhe Social i KB, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet e Detyruara ose të Vullnetshme, Dokumenti i KB i E/CN. 4/1996/38, 1 janar 1996; Komiteti i KB i të Drejtave të Njeriut, *Komenti i Përgjithshëm CCPR Nr. 6: Neni 6 (E drejta për jetë)*, 30 prill 1982 (këtu e tutje Komenti i Përgjithshëm Nr. 6), s. 4; Asambleja e Përgjithshme e KB, *Personat e Zhdukur*, UN Doc A/RES/33/173, 20 dhjetor 1978 (në tekstin e mëtejshëm UN Doc A/RES/33/173); Asambleja e Përgjithshme e KB, *Pyetja e Zhdukjeve të Detyruara ose të Vullnetshme*, UN Doc A/49/610/Add.2, 23 dhjetor 1994.
63. Paneli thekson që gjetjet e ngjashme me sa më sipër janë bërë në një numër lëndësh të kaluara para Panelit. Sidoqoftë, Misioni ka vazhduar të sygjerojë se karakterizimi ligjor i lëndës do të vërtetonte dështimin e tij për të përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Siç është bërë e qartë në rastet e mëparshme, jo.

Priorizimi dhe disponueshmëria e provave

64. Në parashtrirat e tij në lidhje me pranueshmërinë e kësaj ankese (shih, sipër, paragrafi 35), Misioni paraqiti:

‘Duket se EULEX-i nuk e hetoi këtë zhdukje për shkak të mungesës së pistave të dukshme hetimore dhe nevojës për t’i dhënë përparësi lëndëve për të cilat provat ishin më të rëndësishme.’

65. Këto parashresa nuk arrijnë të bindin për arsyet e mëposhtme. Përkundër sygjërimit se kishte një ‘mungesë të pistave të dukshme hetimore’, në fakt kishte disa pista të tilla. Misioni ishte në zotërim të informacionit që kishte të bënte me pronarin e një shtëpie ku pretendohet se të zhdukurit ishin ndaluar. Personat e tjerë që kishin qenë të pranishëm me të zhdukurit në atë kohë mund të identifikoheshin lehtësisht; kishte edhe regjistrin e procesverbalit të ankueses; dhe një dosje të OSBE-së lidhur me lëndën. Paneli nuk sygjeron që ky informacion do të ishte i mjaftueshëm për të sjellë një lëndë në gjykatë. Mirëpo, ishte e mjaftueshme për të filluar një hetim dhe për të verifikuar nëse ndonjë prej këtyre mund të shërbejë si një informacion shtesë. Nga të dhënat, është e qartë se nuk janë bërë përpjekje të tilla.
66. Misioni nuk mund të përdorë dështimin e tij që të kryej hetime për t’u justifikuar me mungesën e informacionit. Informacioni lind nga hetimi, jo e kundërta. Prandaj ishte përgjegjësia e Misionit të provonte dhe të merrte një informacion të tillë. Ndërsa detyrimet e tij në atë drejtim ishin një nga mjetet, e jo rezultat, nga të dhënat shihet se ai as që u përpoq të kërkonte dhe të merrte informacion, përveç asaj që trashëgoi nga UNMIK-u.
67. Lidhur me pretendimin e ‘nevojës për t’i dhënë përparësi lëndëve për të cilat provat ishin më të rëndësishme’ (shih, *sipër*, paragrafët 33-35), Paneli do të vinte në dukje sa vijon. Detyrimet e të drejtave të njeriut të Misionit nuk kufizohen në një mënyrë të tillë. Detyrimet që rrjedhin nga nenet 2 dhe 3 të Konventës për të hetuar këtë lloj të lëndëve duhet të përmbushen, pavarësisht nga cilësia e provave. Për më tepër, siç u përmend më lart, kishte prova mbi të cilat mund të kishte filluar një hetim. Do të ishte absurde nëse një autoritet do të mund të lirojë veten nga detyrimet e tij hetimore për shkak të mungesës së informacionit para se të fillojë të hetojë. Marrja e informacionit është pika kryesore e një hetimi. Nëse, pas një përpjekje efektive dhe të arsyeshme për të hetuar në përpjesëtim me rëndësinë e të drejtave në fjalë, nuk mund të merret asnjë informacion ose informacioni është i pamjaftueshëm, autoritetet nuk mund të mbajnë përgjegjësi për gjetjen e më shumë informacioneve. Sidoqoftë, këtu nuk ndodhi kështu. Misioni as nuk u përpoq as nuk filloi të hetojë. Prandaj nuk mund të përdorë mungesën e informacionit (adekuat ose të mjaftueshëm) si bazë për dështimin e tij për të filluar ndonjë hetim.
68. Paneli gjithashtu vëren në këtë kontekst që Misioni ka deklaruar në lidhje me disa raste të zhdukjes me forcë se rrethanat e detyruan atë të jepte përparësi për kategori të caktuara të lëndëve dhe se nuk mund të pritej të hetonte të gjitha rastet e tilla. Si rezultat, dhe për të vlerësuar meritat e këtyre pretendimeve, në kontekstin e *Miomir Krivokapic kundër EULEX-it*, lënda nr. 2016-13, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, Paneli kërkoi nga Misioni të sigurojë informacion në lidhje me numrin e rasteve të ‘zhdukjes me forcë’ që ishin hetuar dhe/ose ndjekur penalisht nga Misioni gjatë rrjedhës së ekzistencës së tij. Pasi nuk arriti t’i përgjigjej kërkesës së Panelit për atë informacion, Misioni përsëri ishte përkujtuar nga ana e Panelit për kërkesën e tij për të marrë atë informacion. Shih *Miomir Krivokapic kundër EULEX-it*, lënda nr. 2016-13, Vendimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Panelit, 12 Shkurt 2021. Në kohën e këtij Vendimi, informacioni i kërkuar nuk ishte marrë ende. Paneli vëren në lidhje me këtë se nuk ka asnjë provë para tij që Misioni i trajtoi rastet e ‘zhdukjes me forcë’ si përparësi ose që rastet para Panelit të jenë çudira që i shmangen vëmendjes së Misionit. Në vend të kësaj, duket se ato pasqyrojnë dështimin e Misionit për të trajtuar raste të tilla si përparësi dhe për të investuar kohë dhe burime të përshtatshme në përpjekjen për t’i zgjidhur ato.

69. Paneli gjithashtu vëren se në raste të tjera, Misioni kishte sygjëruar që ai kishte priorizuar dhe ishte përqëndruar në rastet e klasifikuara si të "hapura" nga UNMIK-u (mbi ato të karakterizuara nga UNMIK-u si të "mbyllura"). Shih, p.sh., *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 65; *Milorad Trifunović kundër EULEX-it*, 2016-09, 11 dhjetor 2019, par. 96; *Dragiša Kostić kundër EULEX-it*, 2016-10, 13 Shkurt 2020, par. 88; U.F. kundër EULEX-it, 2016-12, 12 shkurt 2020, par. 111; *Miomir Krivaković kundër EULEX-it*, 2016-13, 12 shkurt 2020, par. 108; *Milan Adančić kundër EULEX-it*, 2016-14, 11 dhjetor 2019, par. 96; *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, 2016-17, 4 qershor 2020, par. 54; *S.H. kundër EULEX-it*, 2016-28, 11 shtator 2019, par. 83, *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 99; *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët. 40-41.
70. Kjo lëndë u karakterizua 'e hapur' kur ishte bartur në Mision. Nuk është e qartë pse mbi atë bazë nuk iu dha përparësia që Misioni pretendoi t'u kishte dhënë atyre ndaj rasteve të tjera. Në vend të kësaj, në këtë lëndë, Misioni përqëndrohet në dallimin e pretenduar midis lëndëve të 'personit të zhdukur' dhe 'krimeve të luftës', një klasifikim që nuk ka asnjë lidhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Shih, *sipër*, paragrafët 33-34, 61-63.
71. Siç u përmend më lart (paragrafi 41), Misioni gjithashtu vuri në dukje sa vijon:
- 'Prokurorët e EULEX-it konsideruan që ata duhet të përqëndrohen në veprat e pretenduara penale që janë kryer gjatë konfliktit të armatosur dhe t'ia lënë rastet pas konfliktit zyrove themelore të prokurorisë'.
72. Një shpjegim i tillë nuk jep asnjë justifikim për dështimin e Misionit për të hetuar këtë rast dhe për të mbajtur të informuar të afërmit e të zhdukurve. Së pari, asnjë kufizim i tillë nuk e kufizoi mandatin e Misionit në lidhje me rastet për të cilat ai ishte përgjegjës. As detyrimet e tij për të drejtat e njeriut nuk ishin të kufizuara në një mënyrë të tillë. Në këtë kuptim, për aq sa prokurorët bënë një përcaktim të tillë, ata vepruan a) pa një bazë të duhur ligjore dhe b) në kundërshtim me detyrimet e Misionit për të drejtat e njeriut. Për më tepër, nga praktika e Misionit është e qartë që ata në fakt në disa raste kanë hetuar incidente pas konfliktit.

Njoftimi i të afërmeve të personit të zhdukur

73. Misioni nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim të menjëhershëm për dështimin e tij për të informuar të afërmit e të zhdukurve në këtë rast për veprimet ose vendimin e tij për të mos hetuar këtë rast.
74. Në këtë kontekst, cilësia ose mjaftueshmëria jo e duhur e supozuar e informacionit nuk kishte asnjë ndikim në detyrimin e Misionit për të informuar të afërmit. Me ose pa një informacion të tillë, kërkohet që të informoheshin të afërmit e personave të zhdukur për veprimet dhe përpjekjet e tyre. Ai dështoi ta bënte këtë dhe nuk ka dhënë arsye të arsyeshme për atë dështim.
75. Bazuar në sa më sipër, Paneli konstaton se Misioni dështoi të përmbushë detyrimin e tij sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe nenit 3 të Konventës për të mbajtur të afërmit e ngushtë të z. Daničić të informuar në mënyrë të duhur rreth rrjedhës së veprimit të ndërmarrë për të hetuar zhdukjen e tij.

Nuk ka delegim të detyrimeve të të drejtave të njeriut tek palët e treta

76. Misioni gjithashtu sygjeron që i ka besuar karakterizimit juridik të lëndëve të UNMIK-ut dhe se ka vepruar mbi atë bazë.
77. Paneli nuk mund ta pranojë këtë si arsytim për dështimin e Misionit për të vepruar. Së pari, siç ka nënvizuar Misioni në mënyrë të përsëritur, ai e dinte që të dhënat e UNMIK-ut ishin jo të besueshme. Kjo duhet të kishte ngritur shqetësime në lidhje me cilësinë e punës dhe zellit të dhënë ndaj përgjegjësive të tij hetimore. Edhe nëse jo, përgjegjësitë ndaj të drejtave të njeriut të Misionit ishin të vetat. Ato nuk mund t'u delegohen palëve të treta, përfshirë UNMIK-ut. Pasiviteti i organizatës tjetër ndërkombëtare që merrej me lëndën (ose dështoi të merrej me lëndën) para se të përfshihej EULEX-i nuk e zvogëlon përgjegjësinë e Misionit kur bëhet fjalë për vlerësimin e përbushjes së detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut. Prandaj ishte përgjegjësia e Misionit të rishikonte ato të dhëna (siç bëri) në mënyrë që të formonte mendimin e vet për rrjedhën e veprimit që do të ndërmerrej në lidhje me secilin rast individual. Klasifikimi i rasteve si i hapur/i mbyllur ose person i zhdukur/krim lufte nga UNMIK-u nuk kishte asnjë lidhje ligjore me përgjegjësitë e veta të Misionit.

Mandati i vazhdueshëm ekzekutiv

78. Misioni ka përsëritur një parashtresë që ai i kishte bërë në rastet e mëparshme shkurtimisht se ai ishte i gatshëm të ndihmojë nëse informacionet e reja në lidhje me të afërmin e ankueses do të bëheshin të disponueshme.
79. Paneli tashmë ka shprehur vërejtje e veta në lidhje me parashtresat e tilla, në veçanti, pasi kjo mund t'i japë ankueses përshtypjen se Misioni është ende i përfshirë në hetimin e kësaj lënde. Ai nuk është. Për më tepër, siç është vërejtur tashmë, Misioni e di, natyrisht, se pa një hetim, informacioni i tillë nuk ka gjasa të bëhet i disponueshëm. Prandaj është e nevojshme që Misioni të shtojë përmbajtje në fjalët e veta dhe tani të përpiket të korrigjojë faktin se ai ka dështuar në detyrimet ndaj ankueses për një periudhë të gjatë kohore gjatë së cilës ishte kompetent dhe kërkohej të hetonte rastin e të afërmit të saj. Shih *Q.J. kundër EULEX-it*, 2016-23, Vendimi dhe Gjetjet, 11 dhjetor 2020, paragrafët 60-64.
80. Paneli është ende në pritje të një përgjigje ndaj ftesës së tij që shefi i Misionit duhet të marrë në konsideratë për të miratuar një strategji të plotë dhe efektive për Misionin për ta bërë përparësi të Misionit çështjen e të zhdukurve.
81. Derisa të ndodhë kjo, Paneli do të ftojë Misionin të përmbahet nga përsëritja e 'gatishmërisë së tij për të ndihmuar', e cila tashmë është regjistruar nga Paneli dhe e cila nuk i siguron ndonjë formë të mjetit juridik ankueses, por përkundrazi mund të krijojë pritje të rreme në një situatë të vuajtjeve të vazhdueshme për shkak të zhdukjes së pazgjidhur të një të afërmi të ngushtë.

Përfundime dhe gjetje

82. Bazuar në sa më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka shkelur të drejtat e ankueses sipas nenit 2 (pjesë procedurale) dhe 3 të Konventës duke dështuar të hetojë zhdukjen e të afërmit të saj dhe duke dështuar të sigurojë atë dhe të afërmit e tjerë të ngushtë me ndonjë informacion në lidhje me këtë rast. Duke marrë parasysh seriozitetin e të drejtave në fjalë, peshën e dështimit të Misionit dhe kohëzgjatjen e kohës në fjalë, shkëlja duhet të konsiderohet si veçanërisht serioze. Shkëlja është duke vazhduar ende.
83. Prandaj, ftohet shefi i Misionit të marrë hapa dhe masa që janë në përputhje me këtë fakt.

84. Bazuar në ato gjetje, Paneli e konsideron të panevojshme të bëjë gjetje shtesë në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës. Sidoqoftë, është mjaft e dukshme që sjellja e Misionit ka pasur një efekt negativ në të drejtat e ankueses, siç mbrohen nga ato dispozita. Në vlerësimin e tij se cilat masa ose hapa duhet të ndërmerren për të korrigjuar shkeljet e regjistruara në këtë vendim, shefi i Misionit ftohet të jep shpegime për këtë fakt.
85. Në këtë kontekst, Paneli fton Misionin t'i kushtojë vëmendje të duhur domosdoshmërisë dhe efektivitetit të ngritjes në mënyrë të përsëritur të argumenteve dhe pikave të njëjta, të cilat tashmë janë adresuar në rastet e mëparshme dhe vlerësuar negativisht. Paneli fton Misionin t'i mbështesë parashtrësat e tij në të ardhmen me një analizë të aktiviteteve të Misionit siç shihet nga perspektiva e detyrimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut.
86. Paneli gjithashtu do të ftojë shefin e Misionit të marrë parasysh nevojën që Misioni të kryejë një rishikim transparent dhe efektiv të aktiviteteve dhe trashëgimisë së tij - në veçanti, nga këndvështrimi i detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut - në mënyrë që të nxjerrën mësim nga përvoja e Misionit për përpjekje të tilla në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN se ankesa është e pranueshme në përputhje me nenet 2 (pjesë procedurale), 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

GJEN se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit siç janë të mbrojtura në nenet 2 (pjesë procedurale), 3 të Konventës;

MË TEJ GJEN se shkeljet janë serioze dhe të vazhdueshme dhe se, për këtë arsye, kërkojnë miratimin e masave korrigjuese në përpjesëtim me to;

I BËN THIRRJE shefin e Misionit të zbatojë masa korrigjuese në përpjesëtim me peshën e shkeljeve të përfshira;

GJEN se nuk ka nevojë të bëjë konkluzione mbi meritat në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës;

FTON SHEFIN E MISIONIT, në veçanti, të rishikojë interpretimin e dhënë aktualisht për natyrën dhe fushën e detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe të marrë në konsideratë sa vijon:

1. Paneli fton shefin e Misionit të konsiderojë zyrtarisht pranimin e shkeljes së të drejtave të ankuesit nga Misioni dhe të ofrojë mjet juridik të duhur për të.
2. Paneli fton Misionin të vazhdojë kërkimin dhe identifikimin e zyrës së prokurorisë përgjegjëse për hetimin e kësaj lënde.
3. Paneli më tej fton Misionin të hetojë, si pjesë e veprimtarisë monitoruese, me prokurorin kompetent nëse lënda po hetohet, e nëse jo pse.
4. Paneli fton Misionin të marrë parasysh se cilat hapa konkretë dhe domethënës duhet të ndërmerren për të kontribuar në çuarjen përpara të hetimit të rasteve të zhdukjeve me forcë/personave të zhdukur. Paneli është i gatshëm të vazhdojë të bashkëpunojë me shefin e Misionit në përpjekjen për të gjetur zgjidhje për atë qëllim. Megjithatë, Paneli dëshiron të vërejë se hapat e ndërmarrë deri më tani nga Misioni janë joadekuatë nga pikëpamja e detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe jo

të afta për të kontribuar në mënyrë domethënëse në zgjidhjen e atyre rasteve. Është koha e duhur që Misioni të bëjë më shumë.

5. Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes se cilat mjete juridike janë akoma në dispozicion të Misionit në një rast siç është ky rast ku Misioni është gjetur se ka shkelur të drejtat e një të afërmi të një personi të zhdukur dhe të informojë Panelin në lidhje me konkluzionet e tij.
6. Paneli fton Misionin të shpërndajë këtë vendim në
 - i. Personelin përkatës brenda Misionit;
 - ii. Zyrtarët përkatës të Bashkimit Evropian që kanë përgjegjësi për Kosovën, rajonin e Ballkanit ose çështjet e të drejtave të njeriut.

FTON Misionin t'i raportojë Panelit në lidhje me rekomandimet e mësipërme sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se data 30 nëntor 2021.

Për Panelin,

Guénaél METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare

